VENDIM
Nr.88, datë 22.12.2010

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN "PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT NGA EKSPOZIMET E MËDHA TË BANKAVE"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja "a" dhe të nenit 43 shkronja "c" të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; nenit 57 pika 2, nenit 58 pika 1, shkronjat "b" dhe "c", dhe neneve 62 dhe 64 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave", miratuar me vendimin nr.31, datë 30.4.2008 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 5, shkronja "b" ndryshon si më poshtë:

"titujt (letrat me vlerë) e emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë ose nga Banka e Shqipërisë në monedhë kombëtare".

b) Në nenin 7, pika 6 ndryshon si më poshtë:

"Ekspozimi i bankës ndaj shoqërisë mëmë, filialit të bankës apo një ose më shumë filialeve të shoqërisë mëmë, nuk mund të tejkalojë 20 (njëzet) për qind të kapitalit rregullator.".

c) Në nenin 8, shkronja "b" shtohen pikat iii) dhe v) me përmbajtjen e mëposhtme:

"iii)...të drejtat ndaj bankave dhe institucioneve financiare që veprojnë në vendet e OECD dhe shprehimisht të garantuara prej tyre, me përjashtim të rastit kur këto të drejta, sipas rregullave në fuqi, përfshihen në kapitalin rregullator të tyre; dhe

v)...të drejtat me afat deri në maturim jo më shumë se 1 (një) vit ndaj bankave dhe institucioneve financiare të vendeve që nuk bëjnë pjesë në OECD ose të drejtat mbi 1 (një) vit, të garantuara shprehimisht nga bankat qendrore dhe nga qeveritë qendrore të vendeve që nuk bëjnë pjesë në OECD, me përjashtim të rastit kur këto të drejta sipas rregullave në fuqi përfshihen në kapitalin rregullator të tyre."

d) Në nenin 9 shtohet pika 4 me përmbajtjen e mëposhtme:

"Banka e Shqipërisë, në rastet kur e gjykon të arsyeshme, mund të caktojë kërkesa dhe norma të përkohshme më kufizuese lidhur me ekspozimet e mëdha, të ndryshme nga ato të parashikuara në këtë rregullore. Në këto raste, Banka e Shqipërisë përcakton kohën e vlefshmërisë së zbatimit të këtyre kërkesave/normave, dhe/ose masat dhe kohën e nevojshme për vendosjen e ekspozimeve brenda këtyre kufizimeve, si dhe mënyrën e monitorimit dhe raportimit të tyre.".

2. Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, rast pas rasti urdhëron vendosjen e kërkesave dhe normave të përkohshme më kufizuese lidhur me ekspozimet e mëdha, siç përcaktohet në shkronjën "d" pika 1 të këtij vendimi. Lidhur me këto masa, Guvernatori informon Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë në mbledhjen e tij më të afërt.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohet Departamenti i Stabilitetit Financiar, së bashku me Departamentin e Statistikave për të përgatitur dhe propozuar në Këshillin Mbikëqyrës të gjitha ndryshimet e nevojshme në formularët e raportimit (SRU) që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi.

5. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Europian dhe Komunikimit, për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

6. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani